Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 7
Pasqyra e flukseve monetare[1]

Objektivi

Informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e njësisë ekonomike për të gjeneruar mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare. Vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit kërkojnë një vlerësim të aftësisë së një njësie ekonomike për të prodhuar mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare, si dhe kohën dhe sigurinë e gjenerimit të tyre.

Qëllimi i këtij standardi është që të kërkojë ofrimin e informacionit rreth ndryshimeve historike të mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare nëpërmjet një pasqyre të fluksit monetar, e cila klasifikon fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës prej shfrytëzimit, investimit dhe aktivitetit financiar.

Objekti

1 **Një njësi ekonomike përgatit një pasqyrë të fluksit monetar në përputhje me kërkesat e këtij Standardi dhe e prezanton atë si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të saj për secilën periudhë për të cilën paraqiten pasqyrat financiare.**

2 Ky standard ka zëvendësuar SNK 7 *Pasqyra e ndryshimeve në pozicionin financiar*, të miratuar në korrik 1977.

3 Përdoruesit e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike janë të interesuar për mënyrën sesi njësia ekonomike prodhon dhe përdor mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare. Kjo ndodh pavarësisht nga natyra e aktivitetit të njësisë ekonomike dhe pavarësisht nëse mjetet monetare konsiderohen si produkt i njësisë ekonomike, siç mund të jetë rasti i një institucioni financiar. Pavarësisht se sa të ndryshme janë aktivitetet e të ardhurave apo prodhimeve të njësive ekonomike atyre u nevojiten mjete monetare kryesisht për të njëjtat arsye. Atyre u nevojiten mjete monetare për të zhvilluar operacionet e tyre, për të paguar detyrimet dhe për t´ia kthyer mjetet monetare investitorëve. Si rezultat, ky standard ju kërkon të gjitha njësive ekonomike të dorëzojnë një pasqyrë të fluksit monetar.

Përfitimet e informacionit mbi fluksin monetar

4 Kur pasqyra e fluksit monetar përdoret në lidhje me pjesën tjetër të pasqyrave financiare, jep informacion që i lejon përdoruesit të vlerësojnë ndryshimet në aktivet neto të një njësie ekonomike, strukturën e saj financiare (duke përfshirë aftësinë e saj likuiduese dhe paguese), dhe aftësinë e saj për të pasur ndikim mbi shumat dhe kohën e fluksit të mjeteve monetare në mënyrë që të përshtatet me ndryshimin e rrethanave dhe mundësive. Informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm në vlerësimin e aftësisë të njësisë ekonomike që të gjenerojë mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe i bën të aftë përdoruesit për të zhvilluar modele për të vlerësuar dhe krahasuar vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të njësive ekonomike të ndryshme. Ai rrit dhe krahasueshmërinë e raportimit të performancës së operimit nga njësi të ndryshme ekonomike pasi bën të mundur eliminimin e efekteve të përdorimit të trajtimeve të ndryshme kontabël për të njëjtat transaksione ose ngjarje.

5 Informacioni historik i fluksit monetar shpesh përdoret si një tregues i shumës, i kohës dhe i sigurisë për flukse mjetesh monetare të ardhshme. Ai shërben gjithashtu për të kontrolluar saktësinë e vlerësimeve të mëparshme të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme dhe për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet probabilitetit dhe fluksit neto të mjeteve monetare dhe ndikimit të ndryshimit të çmimeve.

Përkufizimet

6 **Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:**

Mjetet monetare **përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe depozitat me afat.**

[1] Në shtator 2007 si rrjedhojë e ndryshimeve të vitit 2007 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* në SNK 1, BSNK ndryshoi titullin e SNK 7 nga *Fluksi Monetar* në *Pasqyrën e Ndryshimit të Flukseve Monetare*. Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 tek SNRF 18.

Ekuivalentët e mjeteve monetare **janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.**

Flukset monetare **janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.**

Aktivitete të shfrytëzimit **janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.**

Aktivitete investuese **janë blerja dhe nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata dhe investimeve të tjera, jo të përfshira në ekuivalentët e mjeteve monetare, si dhe marrja e interesave dhe dividendëve siç përshkruhet në paragrafët 34A–34D.**

Aktivitete financuese **janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të njësisë ekonomike.**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare

7 Ekuivalentët e mjeteve monetare mbahen me shumë për të plotësuar nevoja afatshkurtra për mjete monetare sesa për investim ose qëllime të tjera. Në mënyrë që një investim të cilësohet si një ekuivalent mjeti monetar, ai duhet të jetë i menjëherë i konvertueshëm në një shumë të njohur mjetesh monetare dhe të jetë subjekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë. Si rezultat, një investim cilësohet normalisht si një ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ai ka një maturim të shkurtër, le të themi prej tre ose më pak muajsh nga data e blerjes. Investimet në kapital neto përjashtohen nga ekuivalentët e mjeteve monetare, përveçse kur ato në thelb janë ekuivalentë të mjeteve monetare, për shembull rasti i aksioneve preferencialë të blera brenda një periudhe të shkurtër maturimi dhe me një datë të specifikuar riblerjeje.

8 Huamarrja bankare zakonisht konsiderohet si aktivitete financiare. Gjithsesi, në disa vende, llogaritë bankare të zbuluara të cilat janë të ripagueshme menjëherë me paraqitjen e kërkesës, formojnë një pjesë përbërëse të menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Në këto kushte, llogaritë bankare të zbuluara përfshihen në përbërje të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare. Një karakteristikë e këtyre rregullimeve bankare është fakti se teprica e llogarisë bankare shpesh ndryshon nga një tepricë pozitive në një tepricë negative.

9 Flukset monetare përjashtojnë lëvizjet ndërmjet elementeve që përbëjnë mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare pasi këto përbërës janë më shumë pjesë e menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike sesa pjesë të aktiviteteve shfrytëzuese, investuese ose financuese. Menaxhimi i mjeteve monetare përfshin investimin e mjeteve të tepërta monetare në ekuivalentë të mjeteve monetare.

Paraqitja e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare

10 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare raporton flukset e mjeteve monetare gjatë periudhës duke i klasifikuar sipas aktiviteteve të shfrytëzimit, investuese dhe financiare. Kur përgatit pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard si edhe kërkesat e përgjithshme për pasqyrat financiare në paragrafët 9–43 dhe 113–114 të SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*.

11 Një njësi ekonomike paraqet fluksin e mjeteve të saj monetare nga aktivitetet shfrytëzuese, investuese dhe financuese në mënyrën që është më e përshtatshme për biznesin e saj. Klasifikimi nëpërmjet aktiviteteve ofron informacion që u lejon përdoruesve të vlerësojnë ndikimin e atyre aktiviteteve mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike dhe shumën e mjeteve të saj monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare. Ky informacion mund të përdoret edhe për të vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet këtyre aktiviteteve.

12 Një transaksion i vetëm mund të përfshijë flukse të mjeteve monetare që janë të klasifikuara ndryshe.

Aktivitetet e shfrytëzimit

13 Shuma e fluksit të mjeteve monetare që krijohet nga aktivitetet e shfrytëzimit është një element kyç për të vlerësuar shkallën në të cilën veprimtaria e njësisë ekonomike ka prodhuar flukse të mjaftueshme mjetesh monetare për të ripaguar huatë, për të mbajtur kapacitetin e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, për të paguar dividendët dhe për të bërë investime të reja pa përdorur burime të jashtme financimi. Informacioni rreth përbërësve specifikë të historisë të flukseve të mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i dobishëm, i marrë së bashku me informacionet e tjera, për të parashikuar flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit në të ardhmen.

 © Fondacioni i SNRF-ve

14 Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit rrjedhin kryesisht nga veprimtaritë që prodhojnë të ardhura të njësive ekonomike. Si rezultat, ato përgjithësisht rrjedhin nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera që hyjnë në përcaktimin e fitimit ose humbjes. Shembuj të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit janë:

(a) mjetet monetare të marra nga shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve;

(b) mjetet monetare të marra nga pagesat për përdorimin e pronës, tarifa, komisione dhe të ardhura të tjera;

(c) pagesat në mjete monetare të furnizuesve të mallrave ose shërbimeve;

(d) pagesat në mjete monetare për dhe në emër të punonjësve;

(e) [fshirë]

(f) pagesat në mjete monetare ose rikthimi i tatimeve mbi të ardhurat, përveç kur ato mund të identifikohen në mënyrë specifike me aktivitete investuese dhe financuese;

(g) mjetet monetare të marra dhe pagesat nga kontratat e realizuara për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi; dhe

(h) mjetet monetare të marra nga dividendët dhe interesat siç përshkruhet në paragrafët 34B–34D.

Transaksione të tilla, si për shembull shitja e një elementi të caktuar të një impianti mund të çojnë në fitime ose humbje që përfshihen në përcaktimin e fitimit ose humbjes. Gjithsesi flukset e mjeteve monetare që lidhen me transaksione të tilla janë flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet investuese. Megjithatë, pagesat për të prodhuar ose blerë aktivet e mbajtura për t'u dhënë me qira të tjerëve dhe të mbajtura për shitje më pas, siç përshkruhet në paragrafin 68A të SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale* janë flukse monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit. Arkëtimet nga qiraja dhe shitja e mëvonshme e aktiveve të tilla gjithashtu klasifikohen si aktivitete shfrytëzimi.

15 Një njësi ekonomike mund të zotërojë letra me vlerë dhe hua për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi, dhe në këto raste ato janë të ngjashme me inventarin blerë specifikisht për rishitje. Si rezultat, fluksi i mjeteve monetare që krijohen nga blerja dhe shitja e ndërmjetësimit ose tregtimit të letrave me vlerë klasifikohet si aktivitete shfrytëzimi. Në mënyrë të ngjashme parapagimet e mjeteve monetare dhe huatë e dhëna nga institucionet financiare zakonisht klasifikohen si aktivitete shfrytëzimi përderisa ato lidhen me veprimtarinë kryesore të prodhimit të të ardhurave të asaj njësie ekonomike.

Aktivitetet investuese

16 Paraqitja veçmas e flukseve monetare që vijnë nga aktivitetet investuese është e rëndësishme sepse flukset monetare përfaqësojnë madhësinë e shpenzimeve të bëra për burimet e përcaktuara për të krijuar të ardhura dhe flukse monetare të ardhshme. Vetëm shpenzimet që sjellin një aktiv të njohur në pasqyrën e gjendjes financiare janë të vlefshme për t'u klasifikuar si aktivitete investuese. Shembuj të flukseve monetare që vijnë nga aktivitetet investuese janë:

(a) pagesat në mjete monetare për të blerë prona, ndërtesa, makineri e pajisje, aktive të afatgjata jo materiale dhe aktive të tjera afatgjata. Këto pagesa përfshijnë ato që lidhen me kostot e kapitalizuara të zhvillimit dhe me aktivet afatgjata materiale të ndërtuara vetë.

(b) mjetet monetare të marra nga shitja e ndërtesave, makinerive e pajisjeve, e aktiveve afatgjata jo materiale dhe e aktiveve të tjera afatgjata.

(c) pagesat në mjete monetare për të blerë instrumente të kapitalit neto ose të borxhit të njësive të tjera ekonomike përfshirë interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (të ndryshëm nga pagesat e atyre instrumenteve që konsiderohen si ekuivalentë të mjeteve monetare ose nga ato që mbahen për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi).

(d) mjetet monetare të marra nga shitja e instrumenteve të kapitalit neto ose të borxhit të njësive të tjera ekonomike përfshirë interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (të ndryshëm nga arkëtimet e atyre instrumenteve që konsiderohen si ekuivalentë të mjeteve monetare ose nga ato që mbahen për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi).

(e) parapagime të mjeteve monetare dhe huatë e dhëna palëve të tjera (të ndryshme nga parapagimet dhe huatë e dhëna nga një institucion financiar).

(f) mjetet monetare të marra nga shlyerja e parapagimeve dhe huave të dhëna palëve të tjera (të ndryshme nga parapagimet dhe huatë e dhëna nga institucioni financiar).

(g) pagesat në mjete financiare për kontratat e të ardhmes (futures & forward), kontratat e opsioneve dhe kontratat e këmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat bëhen për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi, ose pagesat klasifikohen si aktivitete financiare.

(h) mjetet monetare të marra nga kontratat e së ardhmes, nga kontratat forward, nga kontratat e opsioneve dhe kontratat e këmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat bëhen për qëllime ndërmjetësimi ose tregtimi, ose arkëtimet klasifikohen si aktivitete financiare.

(i) mjetet monetare të marra nga interesat dhe dividendët, siç përshkruhet në paragrafët 34A–34D.

Kur një kontratë kontabilizohet si një mbrojtje e një pozicioni të identifikuar, flukset e mjeteve monetare të kontratës klasifikohen në të njëjtën mënyrë si flukset e mjeteve monetare të pozicionit të mbrojtur.

Aktivitetet financiare

17 Paraqitja veçmas për flukset e mjeteve monetare që krijohen nga aktivitetet financiare është e rëndësishme pasi ato shërbejnë për parashikimin e kërkesave për flukset e mjeteve monetare të ardhshme nga ofruesit e kapitalit për njësinë ekonomike. Shembuj të flukseve të mjeteve monetare të krijuara nga aktivitetet financiare janë: Shembuj të flukseve të mjeteve monetare të lindura nga aktivitetet financuese janë:

(a) shumat në mjete monetare të marra nga emetimi i aksioneve ose instrumenteve të tjerë të kapitalit neto;

(b) pagesat në mjete monetare të bëra pronarëve të njësisë ekonomike për të blerë ose rimarrë aksionet e një njësie ekonomike;

(c) shumat në mjete monetare nga emetimi i borxheve, huave, dëftesave premtuese, obligacioneve, huave hipotekare dhe huamarrjeve të tjera afatgjata ose afatshkurtra;

(d) ripagesat e mjeteve monetare për shumat e marra hua;

(e) pagesa në mjete monetare nga një qiramarrës për uljen e detyrimit të mbetur të lidhur me një qira financiare;

(f) pagesat në mjete monetare të dividendëve, siç përshkruhet në paragrafin 33A; dhe

(g) pagesat në mjete monetare të interesave, siç përshkruhet në paragrafët 34A–34D.

Raportimi i flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit

18 Një njësi ekonomike raporton flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit duke përdorur ose:

(a) metodën direkte, ku deklarohen klasat e mëdha të arkëtimeve dhe pagesave bruto të mjeteve monetare; ose

(b) metodën indirekte, ku fitimi ose humbja e shfrytëzimit rregullohet për:

(i) efektet e transaksioneve me natyrë jomonetare;

(ii) çdo shtyrje ose rritje të shkuar ose të ardhshme të arkëtimeve ose pagesave të shfrytëzimit;

(iii) të ardhurat ose shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes për të cilat flukset monetare përkatëse janë klasifikuar si flukse monetare ose nga aktivitetet investuese ose nga aktivitetet financiare; dhe

(iv) flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit për të cilat të ardhurat ose shpenzimet përkatëse nuk janë klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes.

19 Njësitë ekonomike inkurajohen të raportojnë flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit duke përdorur metodën e drejtpërdrejtë. Metoda e drejtpërdrejtë jep informacion që mund të jetë i dobishëm në vlerësimin e flukseve monetare në të ardhmen dhe që i cili është i disponueshëm, nuk sigurohet me metodën e tërthortë. Nëpërmjet metodës së drejtpërdrejtë, informacioni rreth klasave kryesore të mjeteve monetare të marra bruto dhe pagesave bruto të mjeteve monetare mund të merret ose:

(a) nga regjistrimet kontabël të njësisë ekonomike; ose

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) duke rregulluar shitjet, koston shitjeve (interesat dhe të ardhura dhe shpenzime të tjera të ngjashme, dhe tarifa të tjera të ngjashme për një institucion financiar) dhe zëra të tjera të pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me:

(i) ndryshimeve gjatë periudhës në inventarë dhe të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e shfrytëzimit;

(ii) elementë të tjerë jo-mjete monetare; dhe

(iii) zëra të tjerë për të cilat efektet e mjeteve monetare janë flukse monetare investimi ose financimi.

20 Sipas metodës indirekte, fluksi neto i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin ose humbjen e shfrytëzimit me efektet e:

(a) ndryshimeve gjatë periudhës në inventarë dhe të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e shfrytëzimit;

(b) zërave jomonetarë si për shembull amortizimi, provizionet dhe fitimet dhe humbjet neto të parealizuara nga monedhat e huaja të klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit;

(c) të ardhurat ose shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes për të cilat efektet monetare janë flukse monetare investuese ose financiare; dhe

(d) flukset monetare të shfrytëzimit, të tilla si tatimi mbi të ardhurat (në përputhje me paragrafin 35), për të cilat të ardhurat ose shpenzimet korresponduese nuk janë klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Nga ana tjetër, flukset neto të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit mund të paraqiten sipas metodës indirekte duke treguar të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes, ndryshimet gjatë periudhës në inventarët dhe arkëtimet dhe pagesat e shfrytëzimit dhe çdo fluks tjetër të mjeteve monetare të shfrytëzimit për të cilin të ardhurat ose shpenzimet korresponduese nuk janë klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit.

Raportimi i flukseve monetare nga aktivitetet investuese dhe financuese

21 Një njësi ekonomike raporton veçmas klasat e mëdha të faturave të mjeteve monetare bruto dhe pagesat bruto të mjeteve monetare që rezultojnë nga aktivitetet investuese dhe financuese, me përjashtim të rasteve të flukseve monetare të përshkruara në paragrafin 22 dhe 24, që raportohen mbi baza neto.

Raportimi i flukseve monetare në baza neto

22 Flukset monetare që rrjedhin nga aktivitetet e mëposhtme të shfrytëzimit, investimit ose financimit mund të raportohen mbi një bazë neto:

(a) mjetet monetare të marra e të paguara në emër të klientëve kur flukset monetare reflektojnë më shumë aktivitetet e klientit sesa ato të njësisë ekonomike; dhe

(b) mjete monetare të marra dhe të paguara për elementë që kanë qarkullim të shpejtë, elementë që kanë shuma të mëdha dhe elementë me maturime të shkurtra.

23 Shembuj të mjeteve monetare të marra dhe të paguara të cilave u referohet paragrafi 22(a) janë:

(a) pranimi dhe ripagimi i depozitave pa afat të një banke;

(b) fondet e mbajtura për klientët nga një njësi ekonomike investimi; dhe

(c) qiratë e mbledhura në emër të pronarëve të pronave dhe që u paguhen atyre.

23A Shembuj të mjeteve monetare të marra dhe të paguara të cilave u referohet paragrafi 22(b) janë parapagime të bëra për dhe ripagimi i:

(a) shumave principale të lidhura me klientët me kartë krediti;

(b) blerja dhe shitja e investimeve; dhe

(c) hua të tjera afatshkurtra, për shembull ato hua që kanë një periudhë maturimi prej tre ose më pak muajsh.

24 Flukset monetare që rezultojnë nga secila nga veprimtaritë e mëposhtme të një institucioni financiar mund të raportohen mbi një bazë neto:

(a) mjete monetare të marra dhe të paguara për pranim dhe ripagim të depozitave me një datë fikse maturimi;

(b) vendosja e depozitave në institucionet e tjera financiare dhe tërheqja e depozitave nga institucionet e tjera financiare; dhe

(c) parapagime të mjeteve monetare dhe huave të dhëna klientëve dhe ripagim i këtyre parapagesave dhe huave.

Flukset monetare në monedhë të huaj

25 Flukset monetare që krijohet nga transaksionet në një monedhë të huaj do të regjistrohen në monedhën funksionale të njësisë ekonomike duke aplikuar në shumën e monedhës së huaj kursin e këmbimit ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e fluksit monetar.

26 Flukset monetare të një filiali të huaj do të përkthehen me kurset e këmbimit ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datat e flukseve monetare.

27 Flukset monetare të shprehura në monedhë të huaj raportohen në një mënyrë që përkon me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*. Kjo lejon përdorimin e një kursi këmbimi që përafron kursin aktual. Për shembull, mesatarja e ponderuar e kursit të këmbimit për një periudhë mund të përdoret për regjistrimin e transaksioneve në monedhë të huaj ose në përkthim të flukseve monetare të një filiali të huaj. Gjithsesi, SKN 21 nuk lejon përdorimin e kursit të këmbimit në fund të periudhës raportuese kur përkthehen flukset e mjeteve monetare të një filiali të huaj.

28 Fitimet dhe humbjet e parealizuara që lindin nga ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja nuk janë flukse të mjeteve monetare. Gjithsesi, efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare të cilat janë ose duhet të jenë në monedhë të huaj raportohen në pasqyrën e fluksit monetar në mënyrë që të rakordohen mjetet monetare dhe ekuivalentët të mjeteve monetare në fillim dhe në fund të periudhës. Kjo shumë paraqitet veçmas nga flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit, të investimit dhe financimit dhe përfshin ndryshimet, nëse ka, kur këto flukse janë raportuar me kursin e këmbimit të fundit të periudhës.

29 [Fshirë]

30 [Fshirë]

Interesi dhe dividentët

31 Flukset monetare nga marrja ose pagimi i interesit dhe dividentëve do të paraqiten veçmas. Secili do të klasifikohet në mënyrë të qëndrueshme nga njëra periudhë në tjetrën duke zbatuar paragrafët 32, 33A dhe 34A–34D.

32 Shuma totale e interesit të paguar gjatë një periudhe paraqitet në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare nëse ajo është njohur si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose është kapitalizuar në përputhje me SNK 23 *Kostot e Huamarrjes*.

33 [Fshirë]

33A Një njësi ekonomike do të klasifikojë dividendët e paguar si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet financiare.

34 [Fshirë]

34A Një njësi ekonomike, e ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 34B, do të klasifikojë:

(a) interesin e paguar (siç përshkruhet në paragrafin 32) si fluks të mjeteve monetare nga aktivitetet financiare.

(b) interesin dhe dividendët e arkëtuar si fluks të mjeteve monetare nga aktivitetet investuese.

34B Njësia ekonomike që investon në aktive ose ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi (siç përcaktohet duke zbatuar paragrafët B30–B41 të SNRF 18) do të përcaktojë klasifikimin e dividendëve dhe interesit të marrë, si dhe interesit të paguar në pasqyrën e flukseve monetare duke i'u referuar sesi—duke zbatuar SNRF 18—i klasifikon të ardhurat nga dividendët, të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Njësia ekonomike do të klasifikojë totalin e secilit prej këtyre flukseve monetare në një kategori të vetme në pasqyrën e flukseve monetare (që do të thotë ose si aktivitete të shfrytëzimit, ose si aktivitete investuese, ose financiare).

 © Fondacioni i SNRF-ve

34C Gjatë zbatimit të paragrafit 34B, nëse njësia ekonomike klasifikon secilin prej totaleve të të ardhurave nga dividendi, të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve për interesa në një kategori të vetme të pasqyrës së fitimit ose humbjes, ajo do të klasifikojë secilin prej totaleve të dividendëve të marrë, interesit të marrë dhe të paguar, si flukse monetare që vijnë nga aktiviteti përkatës në pasqyrën e flukseve monetare. Për shembull, nëse një njësi ekonomike klasifikon të gjitha shpenzimet për interesa në kategorinë financiare të pasqyrës së fitimit ose humbjes, ajo do të klasifikojë të gjitha interesat e paguar të saj si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet financiare.

34D Kur zbaton SNRF 18, një njësie ekonomike mund t'i kërkohet të klasifikojë secilën të ardhur nga dividendi, të ardhur nga interesat dhe shpenzim për interesa në më shumë se një kategori në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Në një rast të tillë, kur zbaton paragrafin 34B, njësia ekonomike do të zgjedhë një politikë kontabël për të klasifikuar flukset e mjeteve monetare përkatëse në një nga aktivitetet e lidhura me ato flukse në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare. Për shembull, nëse njësia ekonomike klasifikon shpenzimet e interesit në kategorinë e shfrytëzimit dhe në kategorinë financiare të pasqyrës së fitimit ose humbjes, ajo do të klasifikoj të gjithë interesat e paguar në përputhje me politikën e saj kontabël ose si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit ose si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet financiare.

Tatimet mbi të ardhurat

35 Flukset e mjeteve monetare që vijnë nga tatimet mbi të ardhurat do të paraqiten veçmas dhe do të klasifikohen si fluks i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përveç rasteve kur ato mund të identifikohen në mënyrë specifike me aktivitetet financiare dhe investuese.

36 Tatimi mbi të ardhurat rezulton nga transaksionet të cilat sjellin flukse monetare që klasifikohen në një pasqyrë të flukseve monetare si aktivitetet e shfrytëzimit, aktivitet investues ose financues. Ndërsa shpenzimet e tatimeve mund të jenë lehtësisht të identifikueshme për aktivitete investimi dhe financiare, flukset monetare përkatëse të tatimit shpesh janë të pa identifikueshme dhe mund të krijohen në një periudhë të ndryshme nga flukset e mjeteve monetare të transaksionit në fjalë. Si rezultat, tatimet e paguara shpesh klasifikohen si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit. Gjithsesi, kur është e mundur të identifikohet fluksi i mjeteve monetare të tatimit me një transaksion individual që çon në flukse të mjeteve monetare që klasifikohen si aktivitete investuese ose financiare, fluksi i mjeteve financiare të tatimit klasifikohet, në varësi të rastit, si veprimtari investimi ose financiare. Kur flukset e mjeteve monetare të tatimeve janë ndarë për më shumë se një klasë aktiviteti, jepet informacion shpjegues për të gjithë shumën e tatimit të paguar.

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

37 Kur kontabilizon një investim në një pjesëmarrje, një sipërmarrje të përbashkët ose një filial, duke përdorur metodën e kapitalit neto ose të kostos, një investitor e kufizon raportimin e tij në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare vetëm me flukset e mjeteve monetare midis tij dhe të investuarit, për shembull, për dividendët dhe paradhëniet.

38 Një njësi ekonomike që raporton interesin e saj në një pjesëmarrje apo një sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto, përfshin në pasqyrën e flukseve e mjeteve monetare, flukset e mjeteve monetare në lidhje me investimet e saj në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, dhe shpërndarjet dhe pagesat tjera ose arkëtimet midis saj dhe pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët.

Ndryshimet në interesat e pronësisë në filialet dhe njësitë e tjera të biznesit

39 Totali i flukseve monetare që rezultojnë nga blerjet dhe nxjerrja jashtë përdorimi e filialeve ose njësive të tjera të biznesit do të paraqitet veçmas dhe do të klasifikohet si aktivitete investuese.

40 Një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues, në total, përsa i përket blerjeve dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të filialeve apo njësive të tjera të biznesit gjatë periudhës për sa vijon:

(a) shumës totale të blerjes së përgjithshme ose të nxjerrjes jashtë përdorimit;

(b) pjesën e shumës të blerjes ose të marrë nga nxjerrja jashtë përdorimit të realizuar me mjete monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare;

(c) shumës së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare në filial ose njësi biznesi të blera ose të dala jashtë përdorimi; dhe

(d) shumës së aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare në një filial ose njësi biznesi të blerë ose të dalë jashtë përdorimi, të përmbledhur në bazë të kategorive kryesore.

40A Një njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10 *Pasqyra financiare të konsoliduara,* nuk i nevojitet të aplikojë paragrafët 40(c) ose 40(d) për një investim në një filial që i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimi apo humbjes.

41 Paraqitja veçmas e fluksit monetar nga efektet e blerjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimi e filialeve dhe njësive të tjera të biznesit si elementë të një zëri të vetëm, së bashku me informacionin specifik për aktivet dhe detyrimet e blera ose të nxjerra jashtë përdorimi ndihmon në dallimin e atyre flukseve monetare që vijnë nga flukset monetare që rezultojnë nga nga aktivitetet e tjera të shfrytëzimit, investuese dhe financuese. Efektet e flukseve monetare të nxjerrjeve jashtë përdorimit nuk zbriten nga flukset monetare të blerjes.

42 Shuma totale e mjeteve monetare të paguara ose të marra si blerje ose shitje raportohet në pasqyrën e fluksit monetar, mbi baza neto pasi zbriten mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të blera ose të nxjerra jashtë përdorimi si rrjedhojë e të tilla transaksioneve, ngjarjeve ose ndryshimeve në rrethanat.

42A Flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga ndryshimet në interesat e pronësisë në një filial që nuk rezulton në humbje të kontrollit duhet të klasifikohen si flukse te mjeteve monetare nga aktivitetet financiare, përveçse kur filiali është i zotëruar nga një njësi ekonomike investuese sipas përcaktimit ne SNRF 10, dhe i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

42B Ndryshimet në interesat e pronësisë në një filial të cilat nuk çojnë në humbjen e kontrollit, siç mund të jetë blerja apo shitja e mëpasshme nga një shoqëri mëmë e një instrumenti të kapitalit neto të një filiali , kontabilizohen si transaksione të kapitalit neto (shiko SNRF 10), përveçse rastit kur filiali është i zotëruar nga një njësi ekonomike investuese dhe i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për pasojë, flukset e mjeteve monetare që rezultojnë nga ky transaksion klasifikohen në të njëjtën mënyrë si dhe transaksionet e tjera me pronarët siç përshkruhet në paragrafin 17.

Transaksione jo në mjete monetare

43 Transaksionet investuese dhe të financimit që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose të ekuivalentëve të mjeteve monetare do të përjashtohen nga pasqyra e flukseve të mjeteve monetare. Këto transaksione do të shpjegohen gjetkë në pasqyrat financiare në një mënyrë që siguron të gjithë informacionin përkatës për këto aktivitete investimi dhe financimi.

44 Mjaft aktivitete investuese dhe financuese nuk kanë ndikim të drejtpërdrejt në flukset aktuale monetare megjithëse ato kanë ndikim mbi kapitalin dhe strukturën e aktiveve të një njësie ekonomike. Përjashtimi i transaksioneve jo në vlera monetare nga pasqyra e fluksit monetar është në përputhje me objektivin e pasqyrës së fluksit monetar pasi këto elementë nuk përfshijnë fluksin e mjeteve monetare në periudhën aktuale. Shembuj të transaksioneve jo-monetare janë:

(a) blerja e aktiveve ose duke marrë përsipër detyrimet përkatëse në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një qiraje financiare;

(b) blerja e një njësie ekonomike nëpërmjet emetimit të kapitalit neto; dhe

(c) shndërrimi i borxhit në kapital neto.

Ndryshime në detyrimet që rrjedhin nga aktivitete financiare

44A Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese që u mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo monetare.

44B Në përpjekje për të përmbushur masën e nevojshme të kërkesave në paragrafin 44A, një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për ndryshimet e mëposhtme në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare:

(a) ndryshimet nga flukset e mjeteve monetare financiare;

(b) ndryshimet që rrjedhin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera;

(c) efektin e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(d) ndryshimet në vlerën e drejtë; dhe

(e) ndryshime të tjera.

44C Detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare janë detyrimet për të cilat flukset e mjeteve monetare ishin klasifikuar ose flukset e mjeteve monetare të ardhshme do të klasifikohen në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare si flukse monetare nga aktivitete financiare. Përveç kësaj, kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A zbatohet gjithashtu për ndryshimet në aktivet financiare (për shembull, aktivet që mbulojnë detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare) nëse flukset e mjeteve monetare nga këto aktive financiare janë përfshirë ose do të përfshihen në flukset e mjeteve monetare të ardhshme nga aktivitetet financiare.

44D Një mënyrë për të përmbushur kërkesën për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A është kryerja e një rakordimi midis tepricës të çeljes dhe mbylljes në pasqyrën e pozicionit financiar për detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare, duke përfshirë ndryshimet e identifikuara në paragrafin 44B. Kur një njësi ekonomike bën këtë rakordim të tillë, ajo duhet të sigurojë informacione të mjaftueshme për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të lidhin zërat e përfshirë në këtë rakordim me pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare.

44E Nëse një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 44A në kombinim me informacionet shpjeguese për ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare veçmas nga ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera.

Marrëveshjet financiare me furnitorët

44F Një njësi ekonomike duhet të japë informacione për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët (siç përshkruhet në paragrafin 44G) që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet e këtyre marrëveshjeve mbi detyrimet dhe flukset monetare të njësisë ekonomike dhe mbi ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj rrezikut të likuiditetit.

44G Marrëveshjet financiare me furnitorët karakterizohen nga një ose më shumë ofrues financimesh që ofrojnë të paguajnë shumat që një njësi ekonomike u detyrohet furnitorëve të saj dhe njësia ekonomike pranon të paguajë sipas afateve dhe kushteve të marrëveshjeve në të njëjtën datë ose një datë më vonë se pagimi i furnitorëve. Këto marrëveshje i ofrojnë subjektit afate të zgjatura pagese, ose furnitorëve të njësisë ekonomike kushte të pagesës në avancë, krahasuar me datën e pagesës së faturës përkatëse. Marrëveshjet financiare me furnitorët shpesh referohen si financimi i zinxhirit të furnizimit, financimit të llogarive të pagueshme ose marrëveshje të kundërta me faktoringun. Marrëveshjet që janë vetëm përmirësime krediti për njësinë ekonomike (për shembull, garancitë financiare duke përfshirë letrat e kredisë të përdorura si garanci) ose instrumentet e përdorura nga njësia ekonomike për të shlyer drejtpërdrejt një furnizues për shumat që i detyrohet (për shembull, kartat e kreditit) nuk janë marrëveshje financiare të furnitorët.

44H Për të përmbushur objektivat në paragrafin 44F, një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët në lidhje me:

(a) afatet dhe kushtet e marrëveshjeve (për shembull, afatet e zgjatura të pagesës dhe siguria ose garancitë e ofruara). Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të japë informacione të veçanta shpjeguese për afatet dhe kushtet e marrëveshjeve që kanë tregues dhe kushte të ndryshme.

(b) në fillim dhe në fund të periudhës raportuese:

(i) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike, të detyrimeve financiare që janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët.

(ii) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të detyrimeve financiare të paraqitura në pikën (i) për të cilat furnitorët kanë marrë tashmë pagesa nga ofruesit e financimeve.

(iii) intervali i datave të pagesës (për shembull, 30–40 ditë pas datës së faturës) si për detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i) ashtu edhe për llogaritë e pagueshme të shfrytëzimit të krahasueshme që nuk janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët. Llogaritë e pagueshme tregtare të krahasueshme janë, për shembull, llogaritë e pagueshme tregtare të njësisë ekonomike brenda së njëjtës linjë biznesi ose juridiksioni si detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i). Nëse intervali i datave të pagesës është i gjerë, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për atë interval ose të japë informacion shpjegues shtesë (për shembull, intervale të shtresëzuara).

(c) llojin dhe efektin e ndryshimeve jomonetare në vlerat kontabël të detyrimeve financiare të dhëna si informacion shpjegues në (b)(i). Shembuj të ndryshimeve jo-monetare përfshijnë efektin e kombinimeve të biznesit, diferencat e këmbimit ose transaksione të tjera që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre (shih paragrafin 43).

Përbërësit e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare

45 Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues rreth përbërësve të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare dhe paraqet një rakordim të shumave në pasqyrën e fluksit monetar me elementët ekuivalentë të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

46 Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e praktikave të menaxhimit të mjeteve monetare dhe marrëveshjeve bankare në mbarë botën dhe në pajtim me SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare* njësia ekonomike jep informacion shpjegues për politikën që ajo përdor në përcaktimin e përbërjes së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare.

47 Efektet e çdo ndryshimi në politikën e përcaktimit të përbërësve të mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare, për shembull një ndryshim në klasifikimin e instrumenteve financiare që më parë konsideroheshin pjesë e portofolit të investimeve të njësisë ekonomike raportohet në përputhje me SNK 8.

Dhënia e informacioneve të tjera shpjeguese

48 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues së bashku me një koment të drejtimit për shumat e rëndësishme të tepricave të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të mbajtura nga njësia ekonomike dhe që nuk janë të disponueshme për përdorim nga grupi.

49 Ka rrethana të ndryshme në të cilat tepricat e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të zotëruara nga një njësi ekonomike nuk janë të disponueshme për përdorim nga grupi. Shembujt që mund të jepen përfshijnë tepricat e mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare të një filiali që operon në vendin në të cilin aplikohen kontrollet e këmbimit ose kufizime të tjera ligjore kur gjendjet nuk janë të disponueshme për përdorim të përgjithshëm nga shoqëria mëmë ose filialet e tjera.

50 Informacioni shtesë mund të jetë i rëndësishëm për përdoruesit për të kuptuar pozicionin financiar dhe likuiditetin e një njësie ekonomike. Inkurajohet dhënia e këtij informacioni si dhe një komentar nga menaxhimi, dhe që mund të përfshijë:

(a) shumën e huasë së pa tërhequr që mund të jetë e disponueshme për aktivitete të shfrytëzimit në të ardhmen dhe për të përcaktuar kapitalin, duke dhënë kufizimet në përdorimin e tyre;

(b) [fshirë]

(c) shumën totale të flukseve monetare që përfaqëson rritje në kapacitetin shfrytëzues veçmas nga flukset e mjeteve monetare që kërkohen për mirëmbajtjen e kapacitetit të shfrytëzimit; dhe

(d) shumën e flukseve monetare që dalin nga aktivitetet shfrytëzuese, investuese dhe financuese të secilit segment raportimi (shih SNRF 8 *Segmente të shfrytëzimit*).

51 Informacion shpjegues i veçantë për flukset monetare që përfaqësojnë rritje në kapacitetin shfrytëzues dhe për flukset monetare që kërkohen për të mirëmbajtur kapacitetin shfrytëzues është i dobishëm për të mundësuar që përdoruesit të përcaktojnë nëse njësia ekonomike po investon ashtu siç duhet në mirëmbajtjen e kapacitetit të saj shfrytëzues. Një njësi ekonomike që nuk investon mirë në mirëmbajtjen e kapacitetit te saj shfrytëzues mund të paragjykojë probabilitetin për të ardhmen për shkak të likuiditetit aktual dhe shpërndarjeve tek pronarët.

52 Informacioni shpjegues i flukseve monetare u bën të mundur përdoruesve që të kenë një kuptim më të mirë të marrëdhënies ndërmjet flukseve monetare të biznesit si një i tërë me pjesët e tij përbërëse si dhe të disponueshmërisë dhe ndryshueshmërisë të flukseve segmentare të mjeteve monetare.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

53 Ky Standard hyn në fuqi për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose mbas datës 1 janar 1994 e në vazhdim.

54 SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) ndryshoi paragrafët 39-42 dhe shtoi paragrafët 42A dhe 42B. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 2009 e në vijim.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (ndryshuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme. Ndryshimet do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

55 Paragrafi 14 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe të zbatojë paragrafin 68A të SNK 16.

56 Paragrafi 16 është ndryshuar nga *Përmirësimet në SNRF- të*, të publikuara në prill 2009. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2010 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

57 SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta,* të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 37, 38 dhe 42B dhe është hequr paragrafi 50(b). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

58 *Njësitë ekonomike investuese (*ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 42A dhe 42B dhe ka shtuar paragrafin 40A. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2014. Aplikimi më i hershëm i *Njësive Ekonomike Investuese* është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këto ndryshime më herët, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.

59 SNRF 16 *Qiratë*, i publikuar në janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 17 dhe 44. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

60 *Iniciativë mbi dhënie informacionesh shpjeguese* (Ndryshime në SNK 7), i publikuar në janar 2016, shtoi paragrafët 44A–44E. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që nisin nga data 1 janar 2017 e në vazhdim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Kur njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime për herë të parë, nuk kërkohet të japë informacion krahasues për periudhat e mëparshme.

61 SNRF 17 *Kontratat e sigurimit*, i publikuar në maj 2017 ndryshoi paragrafin 14. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 17.

62 *Marrëveshjet Financiare me Furnizuesit*, të publikuara në maj 2023, ka shtuar paragrafët 44F–44H. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2024 ose pas kësaj date. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

63 Kur një njësi ekonomike zbaton *Marrëveshjet Financiare me Furnizuesit*, asaj nuk kërkohet të japi:

(a) një informacion krahasues për çdo periudhë raportimi të paraqitur përpara fillimit të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.

(b) çdo informacion tjetër të kërkuar nga paragrafi 44H(b)(ii)–(iii) në fillim të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.

(c) çdo informacion tjetër të kërkuar nga paragrafët 44F–44H për çdo periudhë të ndërmjetme të paraqitur brenda periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.

64 SNRF 18 i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafët 6, 10, 12, 14, 16–18, 20, 31, 32, 35, 46 dhe 47, shtoi paragrafët 33A dhe 34A–34D, si dhe fshiu paragrafët 33 dhe 34. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

65 *Përmirësime Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit SNRF—Vëllimi 11*, i publikuar në korrik 2024, ka ndryshuar paragrafin 37. Njësia ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2026 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.